

R E P U B L I K A E K O S O V Ë S

/REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO/

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË / OSNOVNI SUD U MITROVICI / BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr. 264/2012

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditeses; Xhemile Beqiri nga Mitrovica te cilen e perfaqson; Avokat nga Mitrovica, kunder te paditurit; nga Mitrovica tani me vendbanim te panjohur te cilin e perfaqson Perfaqsuuesi i perkohshem Avokat; nga Mitrovica sipas aktvendimit te kesaje gjykate, baza e kontestit ; Vertetim pronesie, vlere e lendes se kontestit; 800,00 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.21.09.2015 jep kete;

A K T G J Y K I M

I-APROVOHET kerkespadia e paditeses nga Mitrovica dhe vertetohet se paditesja eshte shfrytzuese e perhershme e pjeses se parc. kat. **3016-5** me kultur are e kl.2 ne vendin e qujtur " siperfaqe prej **S=556m2**, me masa dhe kufi qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes e cila evidentohet ne emer te , ZK-Mitrovica

II- DETYROHET i padituri qe ti njoh kete te drejte paditeses dhe te lejoje qe paditesja kete palujtshmeri ta regjistrojne ne emer te saje prane Drejtorise per Kataster dhe Gjeodezi ne Mitrovica, ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te proedures kontestimore

A r s y e t i m

Paditesja ne padin e parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te saje si dhe ne seancat e mbajtura ka theksuar se gjat vitev ,80-ta ka bler palujtshmerin e cekur ne dispozitiv , ka paguar qmimin e shitblerjes dhe qe nga ateher kete palujtshmeri e ka shfrytzuar pa pengesa gjermetani.

Paditsja tani von ka kuptuar se kjo palujtshemri e cila eshte ne posedim faktik te saje nuk evidentohet ne emer te saje, prandaj ka interes qe kjo palujtshemri edhe juridikisht te evitendohet ne emer te saje.

Pasi qe i padituri eshte ne adrese te panjohur i propozon gjykates qe te njejtit te i caktoj perfaqsuuesin e perkohshem.

I autorizuari i paditeses ne seancen e shqyrtimit kryesore ne fjalen Perfundimtare i propozoi gjykates qe padin dhe precizimin e kerkespadise ta aprovoi si te bazuar nga se paditesja kete palujtshmeri i ka fituar ne baze te shitblerjes dhe mbajtjes me mirbesim.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditeses e konform nen 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK, gjykata me aktvendimet C. nr.264/12 dt 18.06.2015 te paditurit i caktoj Perfaqsesin e perkohshem, Avokat nga Mitrovica i cili ne baze te ketije aktvendimi do ti ushtron te drejtat dhe detyrimet, konform nen. 82.1.2 te LPK.

Perfaqsesi i perkohshem i te paditurve ne pergjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise se paditeseve i propozoi gjykates qe te vendos ne baze te ligjit dhe rezultatit te provave.

Shpenzimet e procedures nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi;. Certifikaten e pronesise P- 71208072-03016-5 dt. 21.09.2015 , Kontraten mbi shitblerjen e palujtshmeris dt. 13.05.1968, Ekspertizen e ekspertit gjeodet dt.28.09.2015 dt., beri veshtrimin ne skicen e terenit nga i njejt ekspert, Kopjen e planit, Proqesverbalin mbi kqyrje ne vend dt.10.09.2015 si dhe ndegjoi deshmitaren dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga Certifikata e pronesise e sipercekur konstatohet se palujtshemria tani lendore evidentohet ne emer te paditurit.

Nga kontrata mbi shitblerjen e palujtshmerise vertetohet se ne cilsi te blersit nga shitesi ka bler palujtshmerin tani lendore ne te cilin ka qene edhe shtepia perdhese nga materiali i forte, me qmim prej 37.500,00 Din.. te cilin qmim e ka paguar ne tersi sipas defteses se bashkangjitur.

Nga konstatimi dhe mendimi i eksperit gjeodet te cekur me larte konstatohet se ; pase matjeve te kryera te palujtshmerise kontestuese dhe ne baze te dokumentacionit me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Katastrit ne Mitrovica, eshte vertetuar se palujtshmeria kontestuese bie —gjegjesishte e perbene parc. e cekur me larte me masa dhe kufij te shenura si ne ekspertizen e dhene me shkrime dhe skicen e terenit te cilat jane pjese perberse te kesaje ekspertize dhe te aprovur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga skica e terenit te sipercekur, shifet shtrirja , perkufizimi dhe siperfaqja e palujtshmerise tani lendore.

Nga procesverbali mi dalje ne vend i kesaj gjykate i sipercekur , Gjyqtari me vrojtim te drejperdrejt ne vend konstaton se ne palujtsherin lendore jane te ndertuara 2-shtepi te banuara dhe se kjo palujtshmeri eshte e perkufizuar fizikisht dhe rrethekuar.

Deshmitarja deklaroi; se i ati i saje njeherit edhe tani paditeses tani i ndjer Nezir Kurti nga shitsi ka bler palujtshmerin tani lendore me qmim prej 37.500,00 Dinar, sipas kontrates interne me shkrim. Ne tersi e ka paguar qmimin e shitblerjes, kane qene diku 5-ari dhe ne ate vend ka qene e ndertuar 1-shtepi, 2-dhomshe. Pase 3-viteve babai ka vdekur keshtu antaret e familje , une dhe motra kemi vazhduar ta shfrytzojm ket palujtshmeri pa kurfar pengese deri me sot. Shtepin e vjeter e kane rrenuar dhe kane ndertuar 2- shtepi familjare per banim.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte , gjykata erdhi ne perfundim dhe konstatoi se patundshmernt tani lendore; baba i paditeses tani i ndjere me 13.05.1969 sipas kontrates interne me shkrim nga shitesi ka bler palutshemrin tani lendore me qmim te shitblerjes prej 37.500,00 Dinar. Ne tersi e ka paguar qmimin e shitblerjes dhe menjeher ka hyre ne shfrytzim dhe disponim te kesaje palujtshmerie pa u pengar nga askush ku ka jetuar sbashku me familjen e tije ne te cilen edhe tani paditesja jetojn dhe e shfrytzzone pa pengesa.

Ne baze te nen 40 te Ligjit per pronetin dhe te drejtat te tjera sendore, Ligji nr. O3/L-154, eshte percaktuar se; Personi i cili me mirbesim e ka njezet [20] vjet ne posedim te panderprer nje palujtshmeri ose nje pjese te saje e fiton pronetin ne te.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes, babai i paditeses si dhe paditesja e ka pasur ne shfrytzim dhe disponim te lire kete palujtshmeri tani lendore dhe ate; me mirbesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ne anen e paditeses ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronsise ne baze te mbajtjes e keto jane; mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme si dhe shfrytzimi i papengushem i ketyre palujtshmerive.

Mbajtja me mirbesim ekziston se babai i paditeses kete palujtsheri e ka bler nga pronari i saje qka vertetohet nga Certifikata e pronesise ne emer te paditurit.

Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekzistn sepse babai i paditeses e ka blere kete palujtshmeri ne vit 1968.

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes babai i paditeses si dhe paditesja kane hyre ne posedim dhe shfrytzim te lire dhe te papengushem te kesaje palujtshmerie e qe edhe tani paditesja e shfrytzzone pa pengesa.

Prandaj gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditeses me mbajtje, konform nen. 40 te Ligjit per pronetin dhe te drejtat te tjera sendore

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore, bazohet në bazë të nen.
450 të LPK.

Nga si u tha më lartë u vendos si në dispozitive të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.264/2012 dt 21.10.2015.

Gjyqtari,
Ragip Kadriu,

**KESHILLE JURIDIKE; Kunder këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet ankese në
afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit, Gjykates së
Apelit të Kosovës e përmes kesaj gjykate.**